REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISE

EKONOMIA DHE BUXHETI

ECONOMY AND BUDGET

SHTATOR – SEPTEMBER
2006

TIRANE

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISE

Raporti Mujor

Shtator 2006

Personi i kontaktit: Luiza JANO
Telefon: ++355 4 258437
E-mail: macro.director@minfin.gov.al
www.minfin.gov.al

PERMBAJTJA

1. VECORITE KRYESORE.....4

2. TIPARE TË TABELAVE SPECIFIKE.....6

   a. IÇK DHE TREGUES TË TJERË.....8
   b. SEKTORI FISKAL.....11
   c. SEKTORI I JASHTEM…… …….13
   d. SEKTORI MONETAR……...……..14

3. TABELAT MBËSHTETËSE

   a. Indeksi i Çmimeve të Konsumit
   b. Kursi i këmbimit
   c. Buxheti i konsoliduar
   d. Shpenzimet institucionale
   e. Shpenzimet sipas funksionit
   f. Investimet
   g. Të ardhurat sipas burimeve
   h. Të ardhurat sipas klasifikimit ekonomik
   i. Financimi i defiçitit
   j. Mjete valutore neto
   k. Krediti i brendshëm
   l. Oferta e parasë
   m. Depozitat sipas burimeve

1. VECORITE KRYESORE :

- **Indeksi i çmimeve te konsumit** ne muajin Shtator 2006, arriti ne 109.4 perqind, duke shenuar nje rritje mujore prej 0.8 përqind, pas rritjes prej 0.2 perqind dhe rritjes prej 0.7 perqind, perkatesisht ne muajt gusht dhe korrik. Norma vjetore e inflacionit, per muajin Shtator ishte 2.6 perqind, duke qendruar brenda objektivit te Bankese se Shqiperise, prej 2 – 4 perqind.



- **Kursi mesatar i kembimit** te monedhes vendase me dy monedhat kryesore te huaja, per muajin Shtator 2006, ishte:

  - 96.76 leke per dollare
  - 123.17 leke per euro



Ne muajin shtator, monedha vendase, u nencmua kundrejt dy monedhave te huaja,monedhes europiane, Euros dhe kundrejt dollarit amerikan. Sjellja e monedhes sone ne tregun vendas eshte reflektimi i sjelljes se dy monedhave ne tregjet nderkombetare monetare si dhe i nderhyrjeve ne treg nga ana e Bankes se Shqiperise.

- Gjate muajit Shtator 2006, **normat e interesit te depozitave** 12-mujore ne leke, kane pesuar nje rritje ne vlere absolute prej 0.07 perqind krahasuar me muajin Gusht, ku normat e interesit ishin 5.12 perqind. Ne muajin Shtator 2006 normat e interesit te depozitave 12-mujore ne leke arriten koten e 5.19 perqind.

Rritje per kete muaj kane pesuan dhe depozitat me afat 6-mujor e krahasuara me muajin paraardhes (Gusht'06) me 0.05 perqind, ndersa normat e interesit per depozitat me afat 3 – mujor dhe 1 – mujor pesuan renie respektivisht me nga 0.01 perqind dhe 0.18 perqind. Rrenie prej 0.16 perqind kane pesuar normat per depozitat me afat 24-mujor, te cilat arriten nivelin e 5.68 perqind.

Krahasuar me te njejten periudhe te nje viti me pare, renien me te larte vjetore e kane patur normat e interesit te depozitave 6-mujore dhe 3-mujore, respektivisht me rreth 0.24 perqind dhe 0.22 perqind.

Normat e interesit te depozitave



	Shtat '05	Tet '05	Nent '05	Dhje '05	Jan '06	Shku '06	Mars '06	Prill '06	Maj '06	Qersh '06	Korr '06	Gusht '06	Shtat '06
12-M	5.28	5.32	5.45	5.57	5.50	5.34	5.28	5.10	5.08	5.05	5.08	5.12	5.19
6-M	4.55	4.75	4.89	4.77	4.95	4.71	4.80	4.60	4.46	4.35	4.23	4.26	4.31
3-M	3.87	4.11	4.17	4.07	4.33	3.41	3.96	3.95	3.85	3.74	3.62	3.66	3.65

❖ Situata buxhetore

Ne fund te muajit Shtator 2006, situata buxhetore, paraqitet si vijon:

1. **Deficiti i pergjithshem** buxhetor arriti ne rreth +10.02 miliarde leke, ose rreth -27.22 perqind e deficitit buxhetor per vitin 2006.
2. **Te ardhurat gjithsej** arriten ne rreth 162.2 miliarde leke ose rreth 70.57 perqind e programit vjetor 2006.
3. **Shpenzimet buxhetore** arriten ne rreth 152.2 miliarde leke, ose rreth 57.07 perqind e totalit te shpenzimeve buxhetore te planifikuara per gjithe vitin 2006.



❖ **Deficiti i pergjithshem** arriti ne +10.02 miliarde leke nga 2.33 miliarde leke te parashikuar per kete periudhe 9-mujore, duke tejkaluar kufijte e parashikuar.

❖ **Të ardhurat gjithsej** arritën në rreth 70.57 përqind të parashikimit vjetor. Ato përfshijnë:

- Mbledhjet e te ardhurave tatimore nga administrata e tatimeve dhe doganave në 70.32 përqind të programimit vjetor;
- Kontributet për sigurimet shoqërore prej 78.41 përqind;

- Të ardhurat jo-tatimore 66.67 përqind e buxhetit vjetor; dhe
- Të ardhurat nga pushteti lokal, 73.10 përqind e planifikimit vjetor

Megjithëse shpenzimet totale ishin rreth 57.07 përqind e buxhetit vjetor, **shpenzimet korrente** arriten ne rreth 137.31 miliardë lekë ose rreth 66 përqind e programimit vjetor, pjesërisht si rezultat i shpenzimeve të larta në pagesat e interesit me rreth 70.68 perqind te buxhetit vjetor, te shpenzimeve per sigurimet sociale me rreth 72 përqind e buxhetit vjetor dhe i shpenzimeve operative dhe te mirembajtjes me rreth 60.3 perqind e buxhetit vjetor.

a. Sektori Fiskal

Buxheti i Konsoliduar

Ne fund te muajit Shtator, jane mbledhur rreth 162.2 miliarde leke te ardhura, perkundrejt shpenzimeve te pergjithshme prej 152.2 miliarde leke, qe perfshijne 137.3 miliarde leke ne shpenzime korente dhe 14.9 miliarde leke shpenzime kapitale.

Si rrjedhim, deficiti ishte ne nivelin e +10.02 miliarde leke.

Mbledhja e te ardhurave perben rreth 70.57 % te te ardhurave buxhetore per vitin 2006, ndersa shpenzimet perbejne 57.07 % te buxhetit te planifikuar. Shpenzimet korente jane rreth 66.08 % e planifikimit vjetor, ndersa shpenzimet kapitale jane rreth 27.15 % e ketij planifikimi.
Nga te ardhurat gjithsej, pjesa e te ardhurave te mbledhura nga Drejtoria e Pergjithshme te Tatimeve dhe Doganave eshte rreth 111.8 miliarde leke (ose rreth 70.32 % e te ardhurave vjetore te planifikuara), te ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor 8.1 miliarde leke (73.1 % e te ardhurave vjetore te planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore 29.2 miliarde leke (78.41 % e te ardhurave vjetore te planifikuara), dhe te ardhurat jo-tatimore ne nivelin e 11 miliarde leke (66.6 % e te ardhurave vjetore te planifikuara).

Nga totali i shpenzimeve korente prej 137.3 miliarde leke, 39.4 miliarde leke (29 %) eshte shpenzuar per personelin, 19.4 miliarde leke (14 %) per interesat, 13.4 miliarde leke (10 %) per shpenzime operative dhe mirembajtje, 1.7 miliarde leke (1 %) per subvencione, 43.4 miliarde leke (32 %) per shpenzimet e

sigurimeve shoqerore dhe shendetsore dhe 12.6 miliarde leke (9 %) per shpenzimet e qeverisjes vendore dhe 7.1 miliarde leke (5 %) per shpenzimet e tjera.

Keto perfaqesojne 66.6 % (shpenzime personeli), 70.6 % (shpenzime per interesat), 60.3 % (shpenzime operative dhe te mirembajtjes), 67.4 % (subvencione), 72 % (sigurimet shoqerore dhe shendetsore), 54.6 % dhe 57.4 % (per shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) perkundrejt buxhetit te planifikuar vjetor.

Shpenzimet kapitale arriten ne rreth 27.1 miliarde leke nga te cilat 75 % financim i brendshem, dhe 25 % financim i huaj.

Shpenzimet kapitale me financim te brendshem llogariten per kete periudhe ne rreth 32.2 % te buxhetit te parashikuar vjetor, ndersa financimi i huaj eshte vetem 18.3 %.

Suficiti prej 10.02 miliarde leke eshte i barabarte me -27.2 % te deficitit buxhetor per 2006.

Të ardhurat sipas Burimeve / Klasifikimit Ekonomik

Te ardhurat gjithsej arriten në fund të muajit Shtator 2006 ne rreth 162.2 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore ne rreth 149.1 miliardë, grantet 2,065 milione dhe të ardhurat jo-tatimore ne rreth 11 miliardë;

Nga totali i të ardhurave tatimore, rreth 111.8 miliardë lekë janë mbledhur nga administrata e doganave dhe e tatimeve, 8.1 miliardë lekë të ardhura nga pushteti lokal dhe 29.2 miliarde leke nga kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore;

Nga të ardhurat totale të mbledhura deri në fund të Shtatorut:

- TVSH përbënte 52.3 miliardë lekë
- Tatimi mbi fitimin 16.6 miliardë lekë
- Taksa doganore 10.4 miliardë lekë
- Taksat nacionale 9.8 miliardë lekë
- Akcizat 16.5 miliardë lekë
- Transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë 2.3 miliardë lekë;

Financimi i Deficitit

Suficiti prej 10.02 miliardë lekë, ne fund te Shtatorit, ishte -112 përqind me financim të brendshëm dhe +12 përqind me financim të huaj. Emetimi i bonove të thesarit ishte mjeti kryesor i financimit të brendshëm, ndersa per financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

❖ Bilanci i pagesave

Bilanci i pagesave per gjashtemujorin e pare 2006, rezultoi me nje sufiçit te pergjithshem prej 56.0 milion Usd. Kjo ishte rezultat i nje:

- defiçiti te Llogarise Korente, prej rreth 368.7 milion usd;
- suficiti te Llogarise se Kapitalit dhe Llogarise Financiare, prej rreth 255.4 milion usd
- bilanci pozitiv ne "Gabime dhe harresa neto" prej rreth 169.2 milion usd

Komponentet kyc te defiçitit te **Llogarise Korente** prej 368.7 milion usd ishin nje:

- bilanc tregtar negativ prej 966.6 milion usd;
- defiçit prej 44.3 milion usd ne bilancin e sherbimeve;
- suficit prej 111.5 milion usd ne bilancin e te ardhurave;
- suficit prej 530.6 milion usd ne transfertat/ te ardhurat nga emigrantet.

- **Oferta totale e parase,** e matur nga M3 arriti në 627 miliardë lekë në fund të muajit Shtator, duke shenuar një rritje prej rreth 11 perqind, krahasuar me te njejten periudhe te nje viti me pare.



Kjo rritje vjetore, erdhi si pasoje e rritjes se **depozitave pa afat** ne leke me rreth 13 perqind, depozitave ne valute me rreth 20 perqind, depozitave me afat ne leke me rreth 8 perqind dhe rritjes te parase jashte sistemit me rreth 3 perqind.



Ndikimin kryesor ne rritjen e ofertes monetare gjate muajit Shtator e kane patur rritja e depozitave me afat ne leke, te cilat vetem gjate ketij muaji u rriten me rreth 4.19 miliarde leke si dhe depozitave ne valute me nje rritje prej rreth 6.32 miliarde leke kete muaj, ndersa depozitat pa afat ne leke pesuan nje rritje te lehte per kete muaj me rreth 0.10 miliarde leke.

2. TIPARE TE TABELAVE SPECIFIKE:

b. Indeksi i Çmimeve te Konsumit dhe tregues të tjerë:

Indeksi i Çmimeve te Konsumit

Indeksi i Cmimeve te Konsumit, per muajin Shtator '06 pesoi nje rritje prej 0.8 perqind, krahasuar me muajt Gusht dhe Korrik, kur ky indeks ishte perkatesisht -0.2 perqind dhe -0.4 perqind. Ndryshimet respektive ne te njejtet muaj te nje viti me pare ishin 0.9 perqind, 0.2 perqind dhe -1.2 perqind.

Rritjen me te madhe mujore, per kete muaj e shenoi grupi "Pije alkolike dhe duhan" me 4.9 perqind, e cila erdhi si rezultat i aplikimit te tarifave te reja mbi akcizen per keto produkte, por pesha specifike relativisht e vogel qe ze ky grup ne shporten e mallrave te konsumit (rreth 3.1 perqind), ben qe edhe ndkimi i saj i drejteperdrejte ne inlacionin vjetore per kete periudhe te jete i vogel.

Ashtu si dhe ne muajin qe kaloi dhe kete muaj rritje per kete muaj shenoi dhe indeksi i cmimeve te grupit "Qera, uje, lend djegese dhe energji" me 2.6 perqind. Kjo rritje erdhi si pasoje e rritjes se cmimit te qerave te banesave, e cila u shkaktua si pasoje e rritjes se kerkeses per strehim per ket e periudhe, krysisht nga studentet me afrimin e vitit akademik.

Uljen me te madhe per kete muaj e pesoi indeksi i cmimeve te grupit "Ushqime dhe pije jo-alkolike" me rreth 0.9 perqind. Kjo ulje erdhi si rezultat i uljes se cmimeve per dy nga nengrupet kryesore te ketij grupi sic ishin "zarzavate perfshi patatet" me rreth - 6.5 perqind dhe "fruta" me rreth -1.5 perqind.

Norma vjetore e inflacionit ne muajin Gusht arriti ne 2.8 perqind duke qendruar brenda objektivit te Bankes se Shqiperise.

Ndryshimet vjetore te indeksit te çmimeve te konsumit, ne perqindje, per vitet 2005 dhe 2006 paraqiten ne tabelen e meposhtme :

	Jan	Shku	Mars	Prill	Maj	Qer	Korr	Gusht	Shta	Tet	Nen	Dhj.
2005	3.3	1.8	1.6	1.3	2.0	2.9	1.8	2.3	3.1	3.3	3.0	2.0
2006	1.4	1.3	1.5	2.4	3.1	2.4	3.2	2.8	2.6			

Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i kembimit te lekut me dollarin amerikan, gjate muajit Shtator shenoi nje rritje prej 1.28 perqind kundrejt muajit Gusht 2006. Ne fund te muajit Shtator, dollari amerikan arriti nivelin 97.07 leke/dollare.

Kursi mesatar i kembimit te lekut kundrejt dollarit amerikan ne muajin Shtator 2006, arriti ne 96.76 leke/dollare.

Kursi mesatar i kembimit te lekut kundrejt Euros ne muajin Shtator 2006, arriti ne 123.17 Leke/Euro, duke shenuar nje rritje te lehte prej 0.68 perqind krahasuar me nje muaj me pare. Ne fund te muajit Shtator nje euro u kembye me 123.02 leke.

Ne ndryshun nga muaji qe shkoi, kete muaj u konstatua nje nencmim i lekut kundrejt dy monedhave kryesore, monedhes europiane Euros prej rreth 0.68 perqind dhe kundrejt dollarit amerikan prej rreth 1.28 perqind.

Ne krahasim me muajin shtator te vitit te kaluar rezulton se monedha shqiptare eshte zhvleresuar ndaj dollarit amerikan ne masen 4.23 perqind dhe kundrejt monedhes europiane, Euro me 0.53 perqind.



Nencmimi i lekut, kundrejt monedhes europiane Euro dhe kundrejt monedhes amerikane, ne rradhe te pare eshte i lidhur me ecurine e tyre ne tregjet monetare nderkombetare, duke reflektuar sjelljen e tyre ne tregun e brendshem monetar. Kursi i kembimit te euros me dollarin amerikan pesoi nje renie mesatare te lehte duke arritur ne rreth 1.273 dollare/euro.

Nder faktoret e brendshem qe kane ndikuar ne ecurine e monedhes vendase gjate muajit gusht permendim: konsolidimi i situates makroekonomike ne vend, efektete e politikes monetare te ndermare nga Banka e Shqiperise, rritja e besimit te publikut ne sistemin

financiar dhe e biznesit tek monedha vendase, renien e flukseve hyrese te monedhes se huaj ne vend si pasoje e mbarimit te sezonit turistik, etj.

Interesi i huave 12-mujore gjate muajit shtator pesoi nje rritje prej 1.015 perqind, duke arritur ne 13.00 perqind nga 11.95 perqind qe ishte ne muajin gusht. Per kete muaj normat per interesin e huave 6-mujore pesuan nje rritje me 3.68 perqind, krahasuar me nje muaj me pare. Interesi i huave 6-mujore per muajin shtator arriti ne 15.64 perqind.



Normat e interesit te bonove te thesarit gjate muajit Shtator 2006, per bonot me maturim 12 mujor, 6 mujor dhe 3 mujor, ishin perkatesisht, 6.92 perqind, 6.25 perqind dhe 5.69 perqind. Gjate ketij muaji vihet re nje rritje e lehte ne Yield-et e bonove te thesarit per te gjitha afatet e maturimit .

c. Sektori i Jashtëm

Bilanci i Pagesave

Tiparet kryesore të bilancit të pagesave për periudhen Janar – Qershor 2006 ishin:

Nje sufiçit i pergjithshem ne bilancin e pergjithshem, prej 56.0 milion usd, rezultat ky i nje:

- defiçiti te Llogarise Korente, prej 368.7 milion usd;
- suficit te Llogarise Kapitale dhe te Llogarise Financiare, prej 255.4 milion usd;
- bilanci pozitiv ne Gabime dhe Harresa neto“ prej 169.2 milion usd;



Komponentet kyc te defiçitit te Llogarise Korente prej 368.7 milion usdo ishin nje:



- bilanc tregtar negativ prej 966.6 milion usd;
- deficit prej 44.3 milion usd ne bilancin e sherbimeve ;
- suficit prej 111.5 milion usd ne bilancin e te ardhurave ;
- suficit prej 530.6 milion usd levizjet e transfertave dhe dergesave.

d. Sektori Monetar

Mjetet Valutore Neto te sistemit bankar

Gjate muajit Shtator 2006, sistemi bankar ka shenuar rritje te mjeteve valutore neto, ne rreth 21.1 miliarde Leke krahasuar me te njejten periudhe te nje viti me pare.



Kjo rritje ka ardhur si pasoje e rritjes se mjeteve valutore neto te bankave te nivelit te dyte, me rreth 21.9 miliarde Leke dhe renies te mjeteve valutore neto ne Banken e Shqiperise me rreth 0.8 miliarede leke.

Ne muajin Shtator sistemi bankar rezulton me nje rritje prej 3.7 miliarde Leke ne mjetet valutore neto, krahasuar me nje muaj me pare (Gusht'06), rritje e cila erdhi si rezultat i rritjes se nivelit te mjeteve valutore neto ne Banken e Shqiperise, me 1.3 miliarde Leke ne krahasim me muajin Gusht si dhe rritjes se mjeteve valutore neto te bankave te nivelit te dyte me rreth 2.3 miliarde Leke.

Kredia per ekonomine

Teprica e kredise per ekonomine ne fund te muajit Shtator 2006 arriti ne 165.4 miliarde leke. Rritja e teprices së kredise, krahasuar me nje vit me pare shenoi vleren 59.7 miliardë leke, me nje rritje prej rreth 56.3 përqind. Kredia e akorduar nga sistemi bankar edhe gjate kesaj periudhe te vitit 2006, ka qene ne rritje, duke vazhduar keshtu trendin pozitiv te nisur qe ne vitin 2005.

Nga struktura e teprices se kredise sipas monedhave vazhdon të mbizoterohet nga kredia në valute, duke perbere rreth 70.2 perqind te totalit te treprices se kredise.

Ashtu si dhe nje muaj me pare edhe kete muaj u vu re qe pesha specifike e kredive per individet, pesoi nje rritje prej 0.3 perqind, duke arritur ne nivelin 33.4 perqind.

Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), per muajin shtator ka shenur nje rritje prej 1.47 perqind, karahasuar me nje muaj me pare. Kjo oferte arriti ne rreth 627 miliardë lekë në fund të muajit shtator duke shenuar nje rritje prej 48.9 miliarde leke kundrejt nivelit te rregjistruar ne muajin dhjetor 2005. Rritja vjetore e ketij treguesi ishte 11 perqind, duke pesuar ulje te ketij ritmi krahasuar me 18.3 perqind qe ishte gjate muajit qershor 2005, por duhet theksuar qe ka pesua rritje ne krahasim me nje muaj me pare.

Raporte te parase jashte bankave



	Sht05	Tet 05	Nen05	Dhj 05	Jan,06	Shk06	Mar-06	Prill06	Maj06	Qer06	Kor06	Gsh06	Sht
PJB/M3	25.0	24.6	24.7	25.9	24.5	24.0	23.7	23.7	23.5	23.7	24.1	23.9	23.3
M3/Depozit	33.3	32.7	30.2	34.9	32.5	31.5	31.0	31.0	30.7	31.1	31.8	31.4	30.4

Raporti i parase jashte bankave ndaj ofertes monetare, ne fund te muajit shtator arriti ne 23.3 perqind duke shenuar nje renie prej 0.6 perqind e krahasuar me muajin gusht. Raporti i parase jashte bankave me depozitat ne muajin shtator arriti ne rreth 30.4 perqind, me nje renie prej 1.0 perqind e krahasuar me muajin gusht'06.

Depozitat ne leke, si perberesi kryesor i ofertes monetare, kane pesuar nje rritje prej 4.2 miliarde leke ne krahasim me muajin gusht 2006. Rritje prej rreth 6.32 miliarde leke ne krahasim me muajin 2006 pesuan depozitat ne valute. Norma vjetore e rritjes se tyre ne fund te muajit shtator arriti ne 20 perqind nga 18 perqind qe ishte ne fund te muajit gusht.

Raporti Depozita/M3



	Sht05	Tet 05	Nen05	Dhj 05	Jan,06	Shk06	Mar-06	Prill06	Maj06	Qer06	Kor06	Gsh06	Sht
Depozite/M3	75.0	75.3	81.7	74.1	75.5	76.0	76.3	76.3	76.5	76.3	75.9	76.1	76.7

Rritja e depozitave në valutë gjatë muajit shtator është mbështetur kryesisht nga rritja e depozitave te sektorit privat, të cilat kanë përbërë rreth 74.2 përqind të rritjes së depozitave totale në valutë.

Depozitat sipas Burimeve

Gjate muajit Shtator 2006:

- Sektori i individeve, zuri nivelin me te larte te depozitave pa afat ne leke me rreth 63.30 perqind, ndjekur nga sektori privat, me rreth 24.91 perqind dhe nga ndermarrjet publike jofinanciare, me 10.21 perqind.
- Individet dhe sektori privat ishin gjithashtu burimi me i rëndësishëm i depozitave në monedhe të huaj, perkatesisht me rreth 74.19 perqind dhe rreth 20.35 perqind.
- Familjarët ishin dukshëm burimi me i rëndësishëm i depozitave me afat në lekë (96.60 përqind e totalit)

Kontribiti i sektoreve ne totalin e depozitave Shtator 2006



- Në përgjithësi, familjarët përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 82.46 përqind) të depozitave totale prej rreth 480 miliardë lekë ne muajin shtator 2006. Ata ndiqen nga sektori privat (13.12 përqind), ndërrmarjet publike jo-financiare (3.50 përqind) dhe autoritetet lokale (0.71 përqind). Institucionet financiare kontribuan me rreth 0.20 për qind ne totalin e depozitave.

- Gjatë muajit shtator 2006, krahasuar me nje muaj me pare, niveli i përgjithshëm i depozitave u rrit dukshem me 10.6 miliardë lekë, si rezultat i rritjes se depozitave me afat ne leke (4.19 miliard leke), dhe rritjes se depozitave pa afat në lekë (me rreth 0.99 miliardë lekë).

- Depozitat pa afat ne leke te familjareve, pesuan nje renie prej rreth 0.73 miliarde leke, ndersa depozitat me afat ne leke te familjareve pesuan nje rritje prej rreth 4.06 miliarde leke.